



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.08.2024)

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 (PBA 25-27), faza e dytë, për sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.**

**Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:09 dhe mbaroi në orën 13:42.**

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Irena Plaku\*** (anëtare)
3. **Gentiana Muçaj\*** (anëtare)
4. **Ridvan Hado\*** (anëtar)
5. **Bledar Bajri** (anëtar)
6. **Albens Tabaku\*** (anëtar)
7. **Markelian Koça\*** (anëtar)
8. **Yllka Rupa\*** (anëtare)
9. **Emona Muçi** (anëtare)

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi** dhe z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 4. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 7. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 (PBA 25-27), faza e dytë, për sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje të gjithëve!

Siç jemi informuar, sot do zhvillohet mbledhja që ka të bëjë me dy çështje të rëndësishme. Pjesa e parë, unë ju kisha vënë në dijeni që do mblidheshim sërish gjatë gushtit, por për shkak të vonesave të krijuara nga Këshilli i Ministrave, mblidhemi sot për miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, faza e dytë, për sistemin gjyqësor.

Ju e dini që ne bëjmë hartimin e këtij dokumenti në dy faza.

Faza e parë, ne e miratojmë gjatë muajit prill dhe faza e dytë, pasi na vijnë tavanet nga qeveria (po e bëj këtë sqarim edhe për anëtarët e rinj), atëherë miratohen tavanet nga fundi i korrikut dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar që të miratojë të gjithë dokumentin bazë për kërkesat buxhetore.

Thjesht një informacion, Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton dy programe buxhetore (tre në fakt – ka të drejtë Xhoda), kemi tre programe buxhetore: kemi Këshillin e Lartë Gjyqësor (që është Këshilli si institucion), janë sistemi gjyqësor (që janë të gjithë gjykatat), dhe i treti është edhe Qendra e Teknologjisë së Informacionit (që është një qendër që është pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor e cila merret me çështjet e teknologjisë së informacionit, jo vetëm për Këshillin e Lartë Gjyqësor por për të gjithë institucionet e drejtësisë). Kështu që, duke qenë se i është ngarkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor që të kujdeset edhe për buxhetin edhe për administrimin e kësaj qendre, atëherë ne duhet të miratojmë edhe buxhetin për këtë qendër.

Kështu që dokumenti ka tre pjesë: pjesa e parë është KLGJ-ja, sistemi gjyqësor dhe Qendra e Teknologjisë. Ajo që ne operojmë gjithmonë është që ne bëjmë kërkesat tona. Jo gjithmonë (Xhoda do e shpjegojë) kërkesat që ne bëjmë janë kërkesa që ne na miratohen nga qeveria, por megjithatë Këshilli i Lartë Gjyqësor adreson të gjithë nevojat që kanë të gjithë gjykatat dhe që Këshilli i Lartë Gjyqësor mendon gjatë veprimtarisë së tij që çfarë kemi nevojë për vitin pasardhës. Pasi ne parashtrojmë nevojat, kemi procedurën tjetër që ia parashtrojmë Ministrisë së Financave, e cila miraton tavanet. Dhe pasi ne miratojmë, në varësi të tavanëve këto nevoja (që Xhoda do na i japë me numra që ku jemi me tavanet), kalojmë në pjesën e negociatave, e cila zhvillohet kryesisht gjatë muajit shtator, tetor, që ndiqet nga Departamenti i Administrimit të Buxhetit dhe pasi zhvillohen edhe negociatat bëhet miratimi në Kuvend ku shkohet për një seancë dëgjimore me Komisionin e Ligjeve dhe më pas miratimi si pjesë e buxhetit shtetëror në tërësi dhe që miratohet, ju e dini shumë mirë, në fund të nëntorit, dhjetor, dhe që është buxheti për 2025.

Kështu që, këto janë me pak fjalë si procedurë se çfarë bëjmë ne në këtë gjë. Unë e di që është një informacion për ju por gradualisht kjo është diçka që bëhet çdo vit dhe që ne kujdesemi çdo vit për buxhetin dhe nevojat që ka sistemi.

Pa humbur kohë, unë do doja që fjalën t'ia jepja Drejtorit të Departamentit të Administrimit dhe Monitorimit të Buxhetit i cili është z. Haxhiu. Shkurtimisht ai do na shpjegojë mbi tavanet që janë miratuar dhe nevojat që kemi ne për buxhetin e vitit pasardhës.

***Xhevdet Haxhiu***: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), 2025-2027, prezanton kërkesat për fonde buxhetore për Sistemin Gjyqësor, ku përfshihet KLGJ, QTI dhe gjykatat e të tre niveleve, për fazën e dytë teknike, duke u mbështetur në vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në funksion të përgatitjes së dokumentit të programit buxhetor, përcaktohet Misioni i Njësisë Publike, pra misioni i grupit buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, mision i cili është i lidhur ngushtë me vizionin e tij.

Në Planin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor (më tej KLGJ) ka të përcaktuar qartë: Vizionin, Misionin, Vlerat, Synimet dhe Objektivat e tij.

Deklarata e Misionit të KLGJ-së, në funksion të përgatitjes së dokumentit të kërkesave buxhetore të PBA 2025 – 2027, është: Të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon ekselencë dhe meriton besimin e publikut.

Po në funksion të dokumentit të PBA-së për grupin buxhetor janë të përcaktuara qartë edhe vizioni i KLGJ-së, politika e programit dhe qëllimi i politikës së programit buxhetor.

Në vijim po parashtrojmë kërkesat buxhetore për sistemin gjyqësor, në mënyrë të detajuar sipas programeve buxhetore dhe grupartikujve kryesorë të shpenzimeve. Ajo që ne do të kërkojmë nga Ministria e Financave, është trajtimi me vëmendje të veçantë i kërkesave tona buxhetore që do parashtrojmë, pasi ato janë pjesë e objektivave të përgjithshme të KLGJ-së si organ qeverisës i sistemit gjyqësor, për zhvillimin e sistemit gjyqësor dhe pjesë e objektivave madhore të zhvillimeve në vendin tonë, drejt integritimit në BE.

Parashtrime të detajuara mbi kërkesat buxhetore dhe tavanet, sipas programeve dhe artikujve kryesore të shpenzimeve, po i paraqesim si më poshtë vijon:

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet strukturës përgjegjëse për administrimin e buxhetit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për burimet njerëzore, për strukturën përgjegjëse për administrimin e gjykatave dhe të teknologjisë së informacionit dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimet juridike, ka përgatitur dokumentin përfundimtar të kërkesave buxhetore 2025 - 2027 për sistemin gjyqësor, faza e dytë, teknike, duke u

mbështetur tërësisht në legjislacionin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesat buxhetore, në fazën e dytë teknike, janë përgatitur duke pasur në vëmendje si tavanet përfundimtare të miratuara, ashtu edhe historikun e realizimit të shpenzimeve buxhetore sipas programeve, gjatë vitit buxhetor 2023 dhe në buxhetin e miratuar për vitin buxhetor 2024 për sistemin gjyqësor.

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025–2027, janë miratuar me VKM nr. 535, datë 12.08.2024 dhe janë të ndara në tre programe buxhetore.

Kërkesat buxhetore për fazën e dytë, për sistemin gjyqësor, janë përgatitur sipas strukturës buxhetore, të përbërë nga tre programe buxhetore, siç e citova më sipër.

Programi 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Programi 01140 “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë (QTISD).

Programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Kërkesat buxhetore në Programin Buxhetor 2025-2027, për të tre vitet buxhetore, duke i krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara, paraqiten sipas pasqyrës së tavaneve të miratuara dhe kërkesave buxhetore, faza e dytë, për sistemin gjyqësor (KLGJ, QTI dhe gjykatat), që ju të gjithë e keni përpara.

Siç shikohet nga pasqyra, kërkesat buxhetore në PBA 2025-2027, për Sistemin Gjyqësor (KLGJ-së, QTI-së dhe Gjykatave), për vitin buxhetor 2025, për të tre programet buxhetore, janë programuar gjithsej në shumën 8,575,528 mijë lekë dhe duke i krahasuar këto kërkesa buxhetore të programuara me fazën së dytë të PBA 2024-2026, të cilat janë në shumën 7,331,450 mijë lekë, janë më të larta në masën 17% ose në vlerë absolute në shumën 1,244,078 mijë lekë, rritje kjo e cila ka ardhur nga rritja e shpenzimeve të personelit, si rrjedhojë e rritjes së pagave; nga detyrimet e pagesave të shpenzimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt rillogariten e pagës dhe dy pagat kalimtare të funksionit të fundit për ish magjistratët (gjyqtarët); nevojat e

marrjes me qira të një ndërtese për nevojat e administrimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nga nevoja për investime për sigurinë kibernetike, shërbimet që lidhen me sigurinë kibernetike; dhe si shkak i rritjes së kërkesave në shpenzime kapitale, në investime, në gjykata.

Ndërsa, tavanet përfundimtare të miratuara me vendimin e sipërcituar për sistemin gjyqësor, për fazën e dytë teknike 2025 - 2027, janë në shumën 4,997,459 mijë lekë, dhe krahasuar me buxhetin e miratuar për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024 në shumën 4,967,559 mijë lekë, janë më të larta në shumën 30,000 mijë lekë ose në masën 0.6%. Me një fjalë, tavanet janë 0.6% më të mëdha sesa buxheti i miratuar për vitin buxhetor 2024 në vazhdim.

Kërkesat buxhetore PBA për sistemin gjyqësor, për vitin 2025, për të tre programet buxhetore, krahasuar me tavanet përgatitor të përgatitura për vitin e parë buxhetor 2025 paraqiten sipas pasqyrës dhe taveve të miratuara dhe kërkesave buxhetore për fazën e dytë, viti buxhetor 2025.

Sikurse shihet nga pasqyra, kërkesat buxhetore për të gjithë sistemin gjyqësor, për vitin 2025, janë programuar në shumën 8,575,528 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara në shumën 4,997,459 mijë lekë, rezultojnë më të larta në masën 72% se tavanet e miratuara ose në vlerë absolute 3,578,069 mijë lekë, më shumë sesa tavanet e miratuara.

Kërkesat buxhetore në programin e KLGJ-së janë programuar në shumën 510,150 mijë lekë, ose në masën 5.9 %, të totalit të kërkesave buxhetore për sistemin gjyqësor.

Kërkesat buxhetore për programin e QTI-së janë programuar në shumën 20,078 mijë lekë ose në masën 0.23 % e kërkesave buxhetore të sistemit gjyqësor.

Kërkesat buxhetore për programin “Buxheti gjyqësor”, për gjykatat, janë programuar në shumën 8,045,300 mijë lekë ose në masën 93.82 % të të gjithë kërkesave të sistemit gjyqësor. Pra buxheti gjyqësor zë pjesën më të madhe të të gjithë buxhetit të sistemit gjyqësor.

Më poshtë po paraqesim kërkesat buxhetore të sistemit gjyqësor për vitin 2025, të paraqitur sipas pemës së programeve buxhetore Përshkrimi i Programit, Qëllimi i Politikës së Programit, Objektivi i programit, Treguesit e Performancës, Produktet e programit. Ajo paraqitet si më poshtë:

Programi 01110 - “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, kërkesat buxhetore të cilat janë për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pema e këtij programi buxhetor është e njëjtë me atë të miratuar në fazën e parë dhe konsiston në përshkrimin e programit, qëllimin e politikës së programit, treguesit e performancës, në nivel qëllimi, objektivin e programit, treguesit e performancës në nivel objektivit dhe produktet e programit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin, ka përgatitur kërkesat buxhetore për periudhën 2025 - 2027, duke u mbështetur në ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesat janë përgatitur duke mbajtur parasysh tavanet buxhetore përfundimtare, realizimin e buxhetit për vitin 2023 dhe buxhetin e vitit 2024, të vitit në vazhdim.

Kërkesat buxhetore, Programi 01110, krahasuar me tavanet e miratuara, paraqiten sipas pasqyrës së e kërkesave buxhetore dhe tavanëve të miratuara PBA 25-27, faza II, për KLGJ-në.

Ndërsa kërkesat buxhetore për vitin 2025 krahasuar me tavanet e miratuara, në mënyrë analitike sipas artikujve të shpenzimeve buxhetore, paraqiten sipas pasqyrës së kërkesave buxhetore dhe tavanëve të miratuara për fazën e II, programi 01110. Dhe siç shikohet nga pasqyra kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 510,150 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet e miratuara në shumën 389,421 mijë lekë, janë më të larta në shumën 120,729 mijë lekë, dhe janë të gjitha në shpenzime korrente, ndërsa kërkesat në shpenzime kapitale janë në të njëjtin nivel me tavanin e miratuar në shumën 15,000 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore në shpenzime korrente ku përfshihen shpenzime paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime të tjera për individët dhe kompensimet familjare, janë programuar në shumën 495,150 mijë lekë, dhe krahasuar me tavanet e miratuara në shumën 374,421 mijë lekë, janë më të larta në shumën 120,729 mijë lekë.

Në shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore) kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 420,500 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet e miratuara në shumën 299,771 mijë lekë, janë më të larta në shumën 120,729 mijë lekë mbi tavanet e miratuar.

Kërkesat në shpenzime paga, janë programuar, vetë në shpenzime paga, janë programuar në shumën 370,500 mijë lekë.

Programimi i kërkesave buxhetore në shpenzime paga është bërë duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi për pagat, në strukturën organizative të administratës së KLGJ-së prej 138 punonjësish, dhe kërkesat e bëra për punonjës shtesë në programin buxhetor 01110.

Për vitin 2025 është kërkuar shtesë për numrin e punonjësve për 30 persona, të cilët konsistojnë në 3 punonjës në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ndërsa 27 punonjës janë bërë shtesë në pozicione të ndryshme (“Këshilltarë juristë”, “Këshilltarë ekonomistë”, “Specialist sekretar gjyqësor”, “Specialist për zbardhjen e redaktimin e vendimeve”, “Specialist/Përkthyes”, “Specialist për pritjen me popullin”, 1 “Specialist Protokoll/Arkivi”) për shkak të detyrimeve ligjore që do të përmbushë KLGJ, pas përfundimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në dhjetor 2024, pasi në pikën 8, të nenit 179/b, Kushtetuta parashikon: “Pas shpërbërjes së Komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Kjo kërkesë është bërë bazuar në materialin e përgatitur nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim në zbatim të Urdhrit nr. 23, datë 08.04.2021 “Për përlllogaritjen e nevojave për burime njerëzore për vitin 2022, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, që konsiston dhe me periudhën pa u shtyrë me ndryshimet kushtetuese afati i funksionimit të KPK-së.

Po ashtu, janë kërkuar edhe 20 punonjës me kontratë të përkohshme gjatë vitit 2025, si çdo vit. Dhe këto do përballohen brenda efekteve të kërkesave buxhetore që kemi bërë.

Në artikullin 601 “Shpenzime për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore”, janë programuar në shumën 50,000 mijë lekë, të cilat janë përlllogaritur në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Në shpenzime operative, artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” janë programuar në shumën 73,150 mijë lekë dhe janë në të njëjtin nivel me tavanin e miratuar për vitin 2025.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, janë hartuar duke pasur për referencë realizimin faktik për vitin 2023, buxhetin e miratuar për këtë artikull, si dhe mbështetur në nevojat e kërkesat e identifikuar në mënyrë analitike nga çdo strukturë



përgjegjëse në KLGJ (Departamenti i IT, Departamenti i Burimeve Njerëzore, Departamenti Juridik si dhe janë parashikuar kryesisht për blerje, kancelari, materiale pastrim dezinfektim, ngrohje, ndriçim, furnizim të tjera dhe të përgjithshme, materiale zyre, furnizim me energji elektrike, ujë, shërbime elektronike, etj.).

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, paraqiten si më poshtë. Në mënyrë analitike do të përdoren në nënartikullin “Materiale zyre dhe të përgjithshme”, nënartikulli “Materiale dhe shërbime speciale”, nënartikulli “Shërbime nga të tretë”, nënartikulli “Shërbime transporti”, nënartikulli “Shpenzime udhëtimi”, nënartikulli “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme”, ku këtu vlen të përmendet se janë parashikuar të përdoren për mirëmbajtje ndërtese, mirëmbajtje rrjete hidraulike e rrjete elektrike, mirëmbajtjen e pajisjeve teknike, sistemi audio - video e sallës së mbledhjeve të KLGJ-së, sistemi i audio-video i sallës së trajnimeve, sistemi i sigurisë së KLGJ-së, uebsajtit të KLGJ-së, sistemi informatik i menaxhimit të burimeve njerëzore; nënartikulli “Detyrime dhe kompensime legale” të cilat janë programuar sipas nevojave të identifikuara për këto shpenzime dhe parashikohen të përdoren për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore; dhe në fund në nënartikullin “Shpenzime të tjera operative”.

Në artikullin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë” janë programuar në shumën 1,500 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht në rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve të telefonisë celulare të përfituesve, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave përkatës.

Ndërsa kërkesat buxhetore për shpenzime korrente, për vitin 2026, janë programuar në shumën prej 495,150 mijë lekë dhe për vitin 2027, janë programuar në shumën prej 499,250 mijë lekë.

Kalojmë në kërkesat për shpenzime kapitale, artikulli 231, të cilat për këtë program janë programuar në shumën 15,000 mijë lekë dhe krahasuar me tavanin janë në të njëjtin nivel si për vitin 2025, të cilat janë parashikuar të përdoren kryesisht për blerje pajisje kompjuterike dhe asistencë teknike, softuer, automjete, dhe plotësimin e nevojave për ushtrimin e aktivitetit të institucionit të KLGJ-së.

Kështu, janë programuar të përdoren në nënartikullin në “Pajisje audio vizuale”, në shumën 700 mijë lekë, bazuar këto në kërkesat e identifikuara dhe të programuara nga struktura përgjegjëse për Teknologjinë e Informacionit në KLGJ; në “Pajisje teknike”,

në shumën 1,550 mijë lekë, bazuar edhe kjo në nevojat e programuara nga struktura përgjegjëse për Teknologjinë e Informacionit; nënartikullin “Orendi zyre” në shumën 790 mijë lekë, bazuar në kërkesat e identifikuar nga Drejtoria e Shërbimeve Administrative; si dhe nënartikulli “Pajisje kompjuterike”, në shumën 2,600 mijë lekë, bazuar në nevojat e kërkesat e strukturave përgjegjëse në KLGJ, ku konsiston në blerje kompjuterash (janë disa terma), pajisje Solid State Drive (SSD) 4 copë, etj.

Tjetër. Janë programuar në shumën (nuk kuptohet shuma në audio), të gjitha në nënartikullin “Softuer dhe program”, të identifikuar nga Departamenti i IT-së për blerje softuer dhe bekapet në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Janë programuar në shumën 9,000 mijë lekë të gjitha në nënartikullin “Automjete” bazuar në nevojat e identifikuar dhe programuara nga Drejtoria e Shërbimeve Administrative për blerje automjetesh.

Kështu, kërkesat buxhetore në shpenzime kapitale (investime), për vitin 2026 dhe 2027, janë programuar në shumën 15,000 mijë lekë, respektivisht për të njëjtin vit, në të njëjtën nivel me tavanet e miratuara buxhetore.

Kalojmë në programin e dytë 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, që konsiston në kërkesat buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së QTI-së. Edhe në këtë program kërkesat buxhetore janë hartuar duke u mbështetur në vizionin, misionin, qëllimin, synimin dhe objektivat strategjik që ka institucioni i QTI-së.

Pema buxhetore edhe për këtë program është e njëjtë me atë të fazës së parë dhe e cila konsiston në deklaratën e misionit, përshkrimin e programit, qëllimin e politikës së programit, treguesit e performancës në nivel qëllimi, objektivin e programit, treguesit e performancës në nivel objektivi, dhe produktet e programit.

Kërkesat buxhetore, për fazën e dytë teknike, janë përgatitur duke pasur parasysh realizimin e vitit 2023, buxhetin e miratuar për vitin 2024, dhe ato së bashku me tavanet përfundimtare të miratuara, për të tre vitet buxhetore, paraqitet sipas pasqyrës së tavanaeve të miratuara dhe kërkesave buxhetore 2025-2027, programi 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”.

Për vitin buxhetor 2025, kërkesat buxhetore për këtë program, krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara, sipas artikujve të shpenzimeve, paraqiten sipas

pasqyrës së tavanëve të miratuar dhe kërkesave buxhetore, për programin 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” viti 2025, faza e II-të.

Sikurse shikohet nga pasqyra, kërkesat buxhetore për vitin 2025, në këtë program, janë programuar në të njëjtën shumë 20,078 mijë lekë, dhe janë të gjitha në shpenzime korrente, dhe krahasuar me tavanet përfundimtare janë të njëjta.

Kërkesat në shpenzime kapitale (investime) siç dihet tashmë janë programuar në 0 lekë për arsye sepse QTI-ja e ushtron funksionin e saj pranë KLGJ-së dhe mbështetet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për të gjitha shërbimet dhe investimet që ka nevojë kjo qendër.

Kërkesat buxhetore në shpenzime korrente konsistojnë në shpenzime personeli, të cilat janë programuar në shumën prej 17,078 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet janë të njëjta. Në artikullin 600, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 14,578 mijë lekë dhe është bërë mbështetur në legjislacionin në fuqi për pagat dhe strukturën organizative të QTI-së është prej 6 punonjësish. Në shpenzime sigurime shoqërore e shëndetësore, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 2,500 mijë lekë, dhe janë llogaritur sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërsa në shpenzime për mallra dhe shërbime (operative) artikulli 602, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 2,976 mijë lekë, dhe krahasuar me tavanet është e njëjtë me këtë shumë.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, janë programuar mbështetur në nevojat dhe përvoja e viteve të kaluara, si dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për blerje materiale të tjera zyre, pagesa ndaj të tretëve, pagesa për honorare mbledhje bordi dhe shpenzime për pjesëmarrje në konferenca, trajnime të ndryshme.

Në shpenzime korrente, artikulli 606 janë programuar në shumën 24 mijë lekë, dhe parashikohet të përdoren kryesisht për rimbursimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për personat që përfitojnë nga VKM-ja përkatëse.

Kështu, kërkesat buxhetore për vitin 2026, janë programuar në shumën 20,200 mijë lekë dhe për vitin 2027, janë programuar në shumën 20,300 mijë lekë.

Siç e citova edhe më sipër, në shpenzime kapitale (investime), kërkesat buxhetore janë programuar në 0 lekë, pasi dihet që qendra ngrihet dhe funksionon pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor i cili siguron ambientet e përshtatshme pune për të. Funksionet mbështetëse horizontale, administrative, financiare e logjistike kryhen për qendrën nga

Këshilli i Lartë Gjyqësor. Edhe për dy vitet në vazhdim, 2026 dhe 2027, kërkesat buxhetore në shpenzime kapitale për këtë program buxhetor janë në shumën 0 lekë. Kaq edhe për këtë program buxhetor.

Tani kalojmë në programin buxhetor më të rëndësishëm të grupit buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili është programi 03310 “Buxheti gjyqësor”, i cili përfshin kërkesat buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave të të tre niveleve.

Edhe për këtë program pema buxhetore është e njëjtë me atë të miratuar në fazën e parë dhe konsiston në deklaratën e misionit, përshkrimin e programit, qëllimin e politikës së programit, treguesit e performancës në nivel qëllimi, objektivin e programit, treguesit e performancës në nivel objektiv, dhe produktet e këtij programi.

Kërkesat buxhetore për programin buxhetor 25-27, programi 03310, krahasuar me tavanet e miratuar për tre vitet buxhetore paraqitet sipas pasqyrës së taveve të miratuara dhe kërkesave buxhetore 25-27, faza e dytë, programi 03310, për buxhetin gjyqësor.

Ndërsa kërkesat buxhetore për vitin e parë buxhetor 2025 të programit 03310 “Buxheti gjyqësor” krahasuar me tavanet e miratuara në mënyrë analitike sipas artikujve të shpenzimeve buxhetore paraqiten sipas pasqyrës së taveve të miratuara dhe e kërkesave buxhetore, faza e II-të, për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”.

Siç shihet nga pasqyra, kërkesat buxhetore për vitin 2025, gjatë fazës së dytë teknike, në këtë program, janë programuar në shumën 8,045,300 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara në shumën 4,587,960 mijë lekë, rezultojnë më të larta se tavanet përfundimtare të miratuara në shumën 3,457,340 mijë lekë.

Më poshtë, në mënyrë analitike dhe ndarë në artikuj e nënartikuj, sipas natyrës së shpenzimeve po paraqesim kërkesat buxhetore për këtë program.

Në shpenzimet korrente të cilat përfshihen shpenzime paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime për individë dhe kompensimet familjare, janë programuar në shumën 5,660,900 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet e miratuara në shumën 4,302,960 mijë lekë janë më të larta në shumën 1,357,940 mijë lekë mbi tavanet përfundimtare të miratuara.

Në shpenzime personeli kërkesat buxhetore janë në shumën 4,706,500 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet e miratuara janë më të larta në shumën 1,022,840 mijë lekë.

Në artikullin 600 “Shpenzime për paga”, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 4,217,500 mijë lekë dhe janë përlllogaritur bazuar në legjislacionin për pagat dhe numrit total të punonjësve të të gjithë gjykatave sipas strukturave organizative të tyre, 1,615 punonjës, gjyqtarë dhe administratë gjyqësore, si dhe për kërkesën për 242 punonjës shtesë në strukturën organike për administratën gjyqësore dhe për 47 punonjës me kontratë të përkohshme.

Theksojmë se në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, sistemit gjyqësor, si asnjë vit tjetër, nuk iu miratua asnjë punonjës shtesë dhe numri në total është i pandryshuar prej 1,759 për të gjithë sistemin, nga të cilët për programin 03310 janë miratuar 1,615 për gjykatat, nga të cilët 408 janë gjyqtarë dhe 1,207 janë administratë gjyqësore.

Në përlllogaritjen e fondeve për paga është mbështetur në organikën në fakt, dhe nga materialet e ardhura nga Departamenti i Burimeve Njerëzore për të gjithë gjykatat, e cila rezulton të jetë 1380, nga të cilët 316 magistratë gjyqtarë në fakt dhe 1064 punonjës të administratës gjyqësore ku përfshihet e gjithë natyra e punonjësve të administratës gjyqësore. Referuar strukturës organizative dhe organikes në fakt, në lidhje me administratën gjyqësore aktualisht rezultojnë 143 vende vakante, nga të cilat 128 janë pozicione nëpunës civilë gjyqësorë dhe 15 punonjës të tjerë gjyqësor. Për sa u përket vakancave të gjyqtarëve rezultojnë, 92 vakanca të përhershme dhe 73 vakanca të përkohshme.

Për vitin 2025, gjatë fazës së dytë të përgatitjes së PBA, 15 gjykata, kanë paraqitur në total 242 kërkesa për pozicione shtesë në strukturën organizative të tyre, për pozicione të ndryshme. Vlen të theksohet këtu vetëm kërkesa për 6 pozicione magistratë gjyqtarë të cilat vijnë në funksion të miratimit të strategjisë së uljes së backlog-ut për Gjykatën Administrative të Apelit.

Janë kërkuar 31 pozicione për këshilltarë ligjorë dhe ndihmës ligjorë. 2 pozicione kryesekretarë, 92 pozicione sekretarë gjyqësorë, 6 pozicione shef sektori, 48 pozicione specialistë të ndryshëm, 21 pozicione shoferë, 14 pozicione ftues, 4 pozicione magazinierë, 6 pozicione punonjës sigurie, 2 pozicione mirëmbajtës dhe 10 pozicione sanitarë.

Për sa i përket pozicioneve të magjistratit, këshilltarit ligjor, ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve, janë mbajtur parasysh kandidatët që do përfundojnë Shkollën e Magjistraturës për vitet buxhetore 2025, 2026, 2027, referuar informacionit të marrë nga Shkolla e Magjistraturës, ku rezulton se për vitin '25 rezultojnë 45 kandidatë për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të mbarojnë Shkollën e Magjistraturës; në 2025 – 15 kandidatë të profilit ndihmës ligjorë; në 2026 me vendimin e KLGJ-së janë miratuar numri i kandidatëve për magjistratë 40 pozicione; dhe për vitin 2027 procesi i verifikimit të kushteve për kandidatët sipas vendimit të KLGJ-së numri i kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, është rreth 20.

Efektet financiarë të kërkesës për 242 punonjës shtesë, sipas pozicioneve të mësipërme është në shumën 435,600 mijë lekë. Po kështu edhe për punonjësit me kontratë ka një efekt financiar prej 40,900 mijë lekë.

Pavarësisht vakancave të magjistratëve gjyqtarë dhe administratës gjyqësore, tavanet përfundimtare të miratuara për vitin 2025, në shpenzime personeli, mbeten shumë të ulëta krahasuar me nevojat reale që ka gjyqësori. Duke u bazuar në organikën faktike të gjykatave, si dhe duke patur parasysh gjykatat të cilat janë duke kryer me shpejtësi procedura rekrutimi për plotësimin e vendeve vakante në administratën gjyqësore, diferenca prej 1,022,840 mijë lekë në shpenzime personeli, vlerësojmë se duhet të merret në konsideratë nga ana e Ministrisë së Financave e cila do jetë edhe objekt diskutimi si në negociatë edhe në prezantimin e kërkesave buxhetore pranë Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Në artikullin “Shpenzime për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore” kërkesat janë programuar në shumën 489,000 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara në shumën 460,000 mijë lekë, rezultojnë më të larta 29,000 mijë lekë, të cilat janë përlllogaritur të gjitha sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesat buxhetore në shpenzime për mallra dhe shërbime (operative), artikulli 602, kërkesat janë programuar në shumën 948,000 në mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara në shumën 612,900 mijë lekë, rezultojnë më të larta në shumën 335,100 mijë lekë se tavanet e miratuara. Kjo diferencë mbi tavanet vjen si rezultat i detyrimeve për pagesat e shpenzimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt rrillogaritje e pagës dhe dy pagat kalimtare të funksionit të

fundit për ish-magjistratët (gjyqtarët); nga nevoja e marrjes me qira të ndërtesës për nevojat e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe nga nevoja e shërbimeve për sigurinë kibernetike, si në KLGJ ashtu në të gjithë sistemin gjyqësor.

Kërkesat buxhetore për këtë program shpenzimesh, për vitin 2025, janë programuar bazuar në administrimin dhe shqyrtimin e kërkesave buxhetore të ardhura nga të gjitha gjykatat, realizimin faktik të vitit 2023, buxhetin e miratuar për këtë artikull gjatë vitit 2024, si edhe duke u mbështetur në nevojat e kërkesat e identifikuara në mënyrë analitike në çdo strukturë përgjegjëse, si në gjykata ashtu edhe në KLGJ.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, në mënyrë analitike paraqiten, si më poshtë:

Në nënartikullin “Materiale zyre dhe të përgjithshme”, në shumën 66,000 mijë lekë.

Nënartikulli “Materiale dhe shërbime speciale” në shumën 15,100 mijë lekë.

Nënartikulli “Shërbime nga të tretë” në shumën 526,000 mijë lekë dhe janë programuar të gjitha duke u mbështetur kryesisht në kërkesat e ardhura nga gjykatat dhe do të përdoren për pagesa ndaj të tretëve në lidhje me shërbimin e kryer nga këto të fundit, si për energjinë elektrike, shpenzime uji, shërbime internet, shërbime poste, abonime të ndryshme, shërbime bankare, shërbimit të pastrimit dhe gjelbërimit, shërbimi i sigurisë dhe ruajtjes së godinave, shërbimi i mirëmbajtjes së RDA, shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit të çështjeve (ICMIS) dhe shërbime të tjera (ekspertë, përkthyes, avokatë, psikologë), me qëllimin e vetëm sigurimin e funksionimit normal të aktivitetit të gjykatave, në të gjitha nivelet, ku pjesën më të madhe e zënë shpenzimet e mëposhtme:

Shpenzimi i ruajtjes dhe sigurisë të godinave dhe ambienteve të të gjitha gjykatave në shumën 107,000 mijë lekë. Shërbimi i mirëmbajtjes së ICMIS-it ekzistues dhe sistemit ARKIT dhe mirëmbajtjen e serverëve të zyrave të shërbimit në shumën 65,000 mijë lekë; shpenzime në mirëmbajtjen e aplikacionit PAKS+ në shumën 50 mijë lekë (kontratë në vazhdim) – kemi disa kontrata në vazhdim; shërbimi i mirëmbajtjes së aplikacionit Infopoint në shumën 500,000 mijë lekë; shpenzimet e shërbimit të mirëmbajtjes të aplikacionit High Court Datacollection në shumën 50 mijë lekë; shpenzimet e mirëmbajtjes së server room dhe Licensa Firewall 6200 dhe 3800 (janë

teknike dhe janë përgatitur nga departamenti i IT-së) dhe 50 licenca VPN në shumën 6,000 mijë lekë (edhe kjo kontratë në vazhdim); shpenzimet për mirëmbajtje dhe licenca për infrastrukturën e sistemit të ri ICMIS në shumën 18,610 mijë lekë (kontratë në vazhdim); shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve Disaster Recovery dhe rinovim licence në shumën 3,600 mijë lekë; shpenzimet e mirëmbajtjes së sistemit RDA nëpër sallat e gjyqit, si edhe suporti teknik për Programin Backup Chain, i cili konsiston në ngarkimin e materialeve audio në shumën 6,500 mijë lekë (kontratë në vazhdim); gjithashtu edhe shërbime të mirëmbajtjes së sistemit RDA nëpër sallat e gjyqit, si edhe mirëmbajtje dhe suportit teknik për Programin Backup Chain, i cili menaxhon materialet audio - video nga gjykata drejt serverit DQRDA në intervale të përcaktuara në 20 gjykata dhe infrastruktura kamera ip si dhe upgrade i FTR për salla gjyqi në shumën 18,600 mijë lekë; shpenzimet për Internet, Intranet për sistemin gjyqësor/ Lidhja dark Fiber /L2/DDOS/Telefoni Fixe në shumën 16,000 mijë lekë; shpenzimet e mirëmbajtjes, suportit teknik për programin m-files, programin sdml lot dhe portalin e-shërbime.klgj.al; shpenzimet të mirëmbajtjes së programit financiar (kontratë në vazhdim); shpenzimet e mirëmbajtjes së regjistrimit të OJF, zhvillime të reja, infrastruktura fizike, licenca (për Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë) në shumën 20,650 mijë lekë, si dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së sistemit "Satisfaction Survey" në shumën 3,000 mijë lekë, shpenzimet e mirëmbajtjes së sistemit të digjitalizimit të arkivave të gjykatave, skanime dhe rritje kapaciteti HË në shumën 28,800 mijë lekë; dhe së fundi shpenzimet në trajnime në fushën e IT në shumën 600 mijë lekë.

Një pjesë e konsiderueshme në këtë nënartikull zënë edhe shpenzimet për qiramarrje ambientesh, janë programuar në shumën 66,000 mijë lekë, për marrjen me qira të një ambienti për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Sikurse dihet tashmë Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë po ushtro aktivitetin e saj në një godinë ekzistuese të ish-Gjykatës së Apelit Tiranë e cila nuk disponon sipërfaqen e nevojshme të punës për të gjithë stafin, sipas riorganizimit të bërë për këtë gjykatë. Në përpjekje për të zgjidhur këtë problem Këshilli i Lartë Gjyqësor, së fundmi me shkresën në prill 2024 i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë duke i parashtruar nevojën urgjente për një godinë ekzistuese me sipërfaqe pune të konsiderueshme, ku do të transferohet Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm,



për të ushtruar veprimtarinë e saj, për një periudhë tranzitore deri në mundësimin e një sheshi ndërtimi për një godinë të re.

Ministria e Drejtësisë, pasi ka marrë përgjigje negative nga të gjithë institucionet qendrore dhe vendore, të cilave iu ishte drejtuar për mundësimin e një godine për transferimin e veprimtarisë administrativo-gjyqësore të gjykatës, ka sugjeruar mundësinë e marrjes me qira, enfitozë ose çdo mjet tjetër juridik, të një ambienti, godine të përshtatshme për transferimin e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Kështu, Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar vlerësimeve të nevojave për sipërfaqe pune, të evidentuara në dokumentin “Detyrë projektimi”, hartuar për këtë gjykatë në korrik të viti të kaluar, për akomodimin e saj nevojitet një sipërfaqe afërsisht 5,000 – 6.000 m<sup>2</sup>, sipërfaqe kjo që parashikohet vetëm për akomodimin e administratës së gjykatës, pa ambiente të tjera ndihmëse si parkim, ambiente të tjera teknike, që në detyrën e projektimit janë të parashikuara në katet nëntokë.

Kosto financiare e vlerësuar sipas dokumentit “Informacion mbi efektet financiare për zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore”, e cila është përcaktuar rreth 10 euro për metër katror, duke marrë në konsideratë sipërfaqen mesatarisht 5.500 m<sup>2</sup>, kosto për një muaj shkon 5.500 mijë lekë. Kështu që kosto për qira vjetore është parashikuar në shumën 66.000 mijë lekë.

Ky grup shpenzimesh që sipër citova do të administrohet në KLGJ 03310 dhe do të realizohet nëpërmjet procedurave të prokurimit të përqendruar për të gjitha gjykatat e të tre niveleve.

Gjithashtu, kërkesat buxhetore janë programuar edhe në shpenzime transporti në shumën 60,800 mijë lekë. Shpenzime udhëtimi në shumën 23,100 mijë lekë. Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme në shumën 43,700 mijë lekë. Në shpenzime për detyrime dhe kompensime legale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që është në shumën 166,200 mijë lekë. Dhe shpenzime të tjera operative në shumën 47,100 mijë lekë.

Po ashtu, në kërkesat buxhetore, të ardhura nga Gjykata e Lartë, janë programuar edhe fondet buxhetore për mirëfunksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), për vitin 2025, e cila konsiston si buxhet shtesë në buxhetin e Gjykatës së Lartë në shumën 4,000 mijë lekë.

Në shpenzime të tjera korrente - Në artikullin 606 – Shpenzime për transferta për buxhete familjare dhe individë janë programuar në shumën 6,400 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për pagesa të kredive të përfituara nga magjistratët gjyqtarë dhe për shpenzimet për rimbursimin e pagesës së limiteve të telefonisë celulare për përfituesit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave përkatës. Pra, në total, kërkesat buxhetore për shpenzimet korrente për programin 03310, për vitin 2025 janë programuar në shumën 5,660,900 mijë lekë. Ndërsa kërkesat buxhetore për shpenzime korrente për vitin 2026 janë programuar në shumën 5,703,900 mijë lekë, për vitin 2027, janë programuar në shumën 5,706,400 mijë lekë.

Në këtë program buxhetor për vitin 2025, gjykatat e të gjitha niveleve, krahas kërkesave për fonde buxhetore, kanë programuar të realizojnë të ardhura të pritshme nga tarifat e shërbimeve gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

Kështu për vitin 2025, gjykatat kanë programuar një realizim të pritshëm të të ardhurave, përafërsisht në shumën prej 30,174 mijë lekë, fonde të cilat parashikohen të përdoren gjatë vitit buxhetor 2025, për plotësimin e një pjese të vogël të nevojave të pambuluara nga fondet buxhetore të miratuara, si në shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera (operative) dhe në shpenzime kapitale (investime) të gjykatave, sipas rastit.

Kalojmë në kërkesat buxhetore në grup shpenzimet kapitale (investime), të cilat në total në artikullin 230, 231 janë programuar në shumën 2,384,400 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përfundimtare të miratuara në shumën 285,000 mijë lekë rezultojnë më të larta në shumën 2,099,600 mijë lekë më shumë sesa tavanet ose 8.4 herë më të larta.

Këto shpenzime janë programuar bazuar në kërkesën e ardhur nga gjykatat, databazës që disponon struktura për investime në KLGJ, dhe parashikon të përdoren kryesisht për studime projektive, ndërtime të reja, rikonstruksione të pjesshme dhe të plota, blerje pajisje të ndryshme IT, blerje orendi dhe pajisje mobilie zyre, blerje mjete transporti, blerje pajisje të tjera teknike, si dhe për të gjithë nevojat e paraqitura nga Departamenti i IT-së për programe softuerë për gjykatat e të gjitha niveleve.

Më poshtë po japim në mënyrë analitike duke u bazuar në kodet e projektit dhe në nënartikujt kërkesat buxhetore në këtë grup shpenzimi. Kështu në artikullin 230 “Investime afatgjata jo materiale” kërkesat buxhetore janë programuar në shumën

118,600 mijë lekë dhe të gjitha në Kodin e Projektit “Studime dhe Projektme”, nënartikullin “Studime, Projektme, Kërkime” dhe janë programuar në bazë të të dhënave që disponon struktura përgjegjëse për investime dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për realizimin e projekteve të zbatimit për ndërtimin e godinave të reja për 5 gjykata, për shtesa godine për 2 gjykata si dhe projektin e dhomës së serverit për 1 gjykatë. Kështu:

- Për Gjykatën e Lartë janë programuar në shumën 28,000 mijë lekë.
- Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë programuar në shumën 20,000 mijë lekë.
- Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në shumën 10,300 mijë lekë.
- Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në shumën 8,700 mijë lekë.
- Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë janë në shumën 38,000 mijë lekë.
- Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë në shumën 480 mijë lekë.
- Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në shumën 13,000 mijë lekë, e cila konsiston për hartimin e projektit të ndërtimit të një shtese anësore të godinës së gjykatës.
- Ndërsa për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë në shumën 120 mijë lekë.

Për vitin 2026 janë programuar për projektin e zbatimit për godinën e re të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në shumën 7,200 mijë lekë dhe në 2027 për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat në shumën 5,400 mijë lekë.

Kalojmë në kërkesat buxhetore në artikullin 231 “Investime afatgjata materiale”, kërkesat janë programuar në shumën 2,265,800 mijë lekë (për vitin 2025), pasi projektet për ndërtimin e godinave të reja shtrihen në disa vite buxhetore.

Kërkesat buxhetore sipas kodit të projektit dhe nënartikujt po i evidentojmë në këtë artikull buxhetor si më poshtë:

Kodi i projektit “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë” janë programuar në shumën 1,040,400 mijë lekë, nga të cilat në nënartikullin “Ndërtime (ndërtesa administrative), kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 850,000 mijë lekë.

Sikurse jeni në dijeni tashmë në çdo vit buxhetor, gjatë përgatitjes të dokumentit të projektbuxhetit afatmesëm për sistemin gjyqësor, nga ana jonë janë programuar dhe përfshirë në kërkesat buxhetore nevojat për ndërtimin e godinave të reja për disa gjykata, të cilat nuk kanë sipërfaqen e nevojshme pune dhe për të ushtruar aktivitetin e tyre, nuk plotësohen standardet e organizimit të brendshëm funksional dhe standardet e sigurisë si dhe nuk ka mundësi zgjerimi me ndërtesat ekzistuese të gjykatave, kjo edhe si rezultat i riorganizimit të gjykatave.

Kërkesat buxhetore në këtë nënartikull janë programuar bazuar në nevojat që paraqet infrastruktura ndërtimore e disa gjykatave, dhe janë evidentuar nevojat për ndërtesa të reja, në mënyrë analitike si më poshtë:

Për Gjykatën e Lartë: Kostoja paraprake e parashikuar për realizimin e projektit për godinën e re, programuar çdo vit gjatë vitit PBA është në shumën 1,100,000 mijë lekë.

Sikurse dihet, ndërtesa aktuale e Gjykatës së Lartë nuk disponon sipërfaqen e nevojshme të punës në raport me stafin administrativ të saj.

Qëllimi i projektit të investimit është ofrimi i kushteve optimale të punës dhe sigurimin për gjyqtarët dhe stafit administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe ofrimi i një shërbimi cilësor dhe transparent për publikun. Për Gjykatën e Lartë, për këtë vit buxhetor, ju bëj me dije, është miratuar edhe detajimi i shumës 28,000 lekë, me qëllim hartimin e projektit të zbatimit për ndërtesën e re të gjykatës, por duke qenë se realizimi i këtij fondi është i lidhur ngushtë me sheshin e ndërtimit (për sigurimin e sheshit të ndërtimit), për të cilin ende nuk kemi zhvillime të reja, me gjithë përpjekjet e mëdha që ka bërë KLGJ-ja, ky fond u rishpërnda dhe për këtë arsye u riprogramua përsëri në vitin 2025. Sjellim në vëmendje se, për hartimin e projektit të zbatimit është përgatitur gjatë vitit 2022 dokumenti “Detyrë projektimi”, i cili u hartua në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë dhe specialistë të Këshillit të Lartë Gjyqësorë. Ky projekt është parashikuar të realizohet për një periudhë kohore 3-vjeçare, e shtrirë në tre vite buxhetore, duke planifikuar fillimin e punimeve të ndërtimit në vitin 2025 në shumën 300,000 mijë lekë, në vitin 2026 në

400,000 mijë lekë dhe në përfundimin e plotë të objektit në vitin 2027 në shumën 400,000 mijë lekë.

Po ashtu, ju bëj me dije se për godinën e re të Gjykatës së Lartë, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është propozuar pranë Ministrisë së Drejtësisë për t'u përfshirë në "listën unike të projekteve me rëndësi kombëtare", dhe është propozuar për t'u bërë pjesë edhe e programit IPA III 2025-2027.

Kemi programuar fonde për ndërtimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë: Kostoja paraprake e parashikuar për realizimin e këtij projekti për godinën e re është në shumën 726,000 mijë lekë. Siç e citova edhe më sipër godina aktuale e Gjykatës së Apelit nuk ofron mundësi për akomodimin e stafit të gjykatës së re, e cila ka një staf të shumëfishuar për shkak të organizimit në një gjykatë të vetme apeli. Ky projekt është parashikuar të realizohet për një periudhë kohore 3-vjeçare, e shtrirë në tre vite buxhetore, në rastin më të mirë duke filluar në vitin 2025 në shumën 250,000 mijë lekë, dhe duke vijuar pastaj me dy vitet e tjera buxhetore 2026 dhe 2027.

Po ashtu edhe për godinën e Gjykatës së Apelit është propozuar pranë Ministrisë së Drejtësisë për t'u përfshirë në "listën unike të projekteve me rëndësi kombëtare", dhe është propozuar për t'u bërë pjesë e programit IPA III 2025-2027.

Projekti i investimit për ndërtesën e re të kësaj gjykate është bërë pjesë e planit të veprimit të zbatimit për strategjinë ndërsektorale të drejtësisë 21-25, miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 823, datë 24.12.2021 (por deri tani nuk kemi asnjë lloj zhvillimi).

Ndërtimi i godinës së re për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë: Kostoja paraprake e parashikuar për realizimin e këtij projekti për godinën e re është 1,500,000 mijë lekë.

Projekti i investimit të propozuar për këtë gjykatë ndërmjet një ndërtese të re do të mundësojë hapësirën e nevojshme të punës si dhe do të garantojë një ndërtesë me skemë të brendshme të organizuar në përputhje me standardet bashkëkohore të punës dhe sigurinë për gjykatat.

Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, KLGJ, për t'i paraprirë projektit të investimit, ka përfunduar dokumentin e “Detyrës së projektimit” për këto dy godina.

Ky projekt është parashikuar të realizohet për një periudhë 3-vjeçare të tre viteve buxhetore duke filluar në rastin më të mirë për vitin 2025 në shumën 300,000 mijë lekë dhe duke vijuar për vitin 2026 dhe vitin 2027.

Po ashtu bëj me dije edhe këtu që ndërtimi i godinës së re të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është propozuar Ministrisë së Drejtësisë për t'u përfshirë në “listën unike të projekteve me rëndësi kombëtare”, dhe është propozuar për t'u bërë pjesë e programit IPA III 2025-2027.

Për vitin 2026, kërkesat buxhetore janë programuar për fillimin e ndërtimit të godinave të reja për: Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Për të dyja këto gjykata ju bëj me dije se KLGJ-ja i ka propozuar Ministrisë së Drejtësisë për t'u bërë pjesë e programit IPA III 2025-2027.

Për vitin 2026 është programuar edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë: Kostoja paraprake e realizimit të projektit për shtesën e godinës ekzistuese e cila është në shumën 386,660 mijë lekë. Ky projekt është parashikuar të realizohet për një periudhë 2-vjeçare, e shtrirë në dy vite buxhetore, pra në vitin 2026 dhe 2027.

Ndërsa kërkesa për vitin 2027 është programuar për ndërtimin e godinës së re në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Dhe ky projekt parashikohet të shtrihet për një periudhë 2-vjeçare, e shtrirë në dy vite buxhetore, 2027-2028.

Edhe për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë i është propozuar Ministrisë së Drejtësisë për t'u bërë pjesë e programit IPA III 2025-2027.

Kalojmë në nënartikullin “Rikonstruksione të tjera ndërtimore” - kërkesat buxhetore për këtë nënartikull janë programuar në shumën 190,400 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për rikonstruksionin e pjesshëm të godinave të 9 gjykatave. Kështu:

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, në shumën 18,000 mijë lekë, rikonstruksion i cili ka filluar që në vitin buxhetor 2024 me

akordimin e shumës 23,300 mijë lekë, pasi preventivi i përfundimit të punimeve sipas projekt-idesë dhe hartimit me porosi nga vetë gjykata ishte në shumën totale 41,300 mijë lekë, për realizimin e punimeve të rikonstruksionit të godinës ekzistuese të gjykatës së Kuksit.

Po ashtu Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në shumën 47,600 mijë lekë, pasi për këtë gjykatë Këshilli ka rishpërndarë fonde gjatë vitit 2024 për të hartuar dokumentin e projektit të zbatimit për sistemin ngrohje-ftohje-ventilim (VRF) dhe projektin e zbatimit të BMS (Building Management System) në vlerën totale 6,850 mijë lekë. Instalimi i sistemit të ri të ngrohje-ftohje-ventilim (VRF) u programua në shumën 38,000 mijë lekë si dhe zëvendësimi i sistemit aktual të BMS (Building Automatic System) është programuar në shumën 9,600 mijë lekë.

Gjithashtu janë programuar fonde në Gjykatën e Elbasanit në shumën 1,100 mijë lekë për nevoja për riparime hidroizolimi të një pjese të tarracës.

Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në shumën 17,800 mijë lekë për përshtatjen e dhomës së serverit.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në shumën 10,200 mijë lekë edhe kjo për përshtatjen e dhomës së serverit.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në shumën 21,000 mijë lekë, për përshtatjen e dhomës së serverit.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, shumën 2,700 mijë lekë për riparime të pjesshme të ndërtesës së gjykatës ekzistuese dhe të ish-Gjykatës së Apelit Korçë.

Ndërsa për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është në shumën 70,000 mijë lekë për realizimin e shtesës së katit mbi dhomën penale dhe shtesë anësore katërkatëshe mbi ndërtimin ekzistues në shumën 30,440 mijë lekë si dhe rikonstruksionin e godinës ekzistuese në shumën 200,450 mijë lekë. Pra në total në shumën 230,880 mijë lekë. Rikonstruksioni i Gjykatës së Tiranë është programuar të shtrihet, për vetë volumin e madh të punës, është programuar të shtrihet në dy vite buxhetore 2025-2026, dhe për vitin 2025, duke mbajtur parasysh afatet e hartimit e projektit të zbatimit, afatet për miratimin e lejes së ndërtimit, dhe procedurat e

prokurimeve për vitin 2025 është parashikuar shuma 70,000 mijë lekë dhe për vitin 2026 pjesa tjetër e shumë së mbetur prej 160,880 mijë lekë.

Gjithashtu edhe për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është programuar në shumën 2,000 mijë lekë për rikonstrukcionin e katit nëntokë ku ndodhen ambientet e izolimit dhe vendqëndrimi i të pandehurve.

Për vitin buxhetor 2026 për “Rikonstrukcione të tjera ndërtimore” janë programuar fonde për Gjykatën e Shkallës së Parë Sarandë për shtesën anësore të godinës dhe për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, faza e dytë e punimeve, siç e citova më sipër, shkalla e parë Tiranë.

Për vitin buxhetor 2027, “Rikonstrukcione të tjera ndërtimore” nuk janë paraqitur kërkesa buxhetore nga asnjë gjykatë, por nisur nga historiku i realizimit të fondeve buxhetore për rikonstrukcione të pjesshme të 3-viteteve të kaluara, nga ana jonë janë programuar fonde në shumën 120,000 mijë lekë.

Kalojmë në kodin e projektit “Programe Software” për gjykatat.

Për vitin 2025 kërkesat buxhetore janë programuar gjithsej në shumën 669,180 mijë lekë dhe janë të gjitha në nënartikullin “Instalimi i sistemit të kompjuterëve”, (Programe software), të cilat janë programuar bazuar në nevojat e identifikuara nga Departamenti i IT-së në KLGJ dhe parashikohen të përdoren kryesisht për realizimin e disa projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit, si më poshtë:

Tashmë jemi të njohur çdo vit, nga viti 2022, kërkesa buxhetore për projektin e një sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, projekt i cili është mbështetur në Udhërrëfyesin me titull “Udhërrëfyes për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore” i cili është miratuar me vendim të bordit të qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë. Gjykatat shqiptare kanë nevojë emergjente për një sistem të ri të menaxhimit të çështjeve. Ky projekt është parashikuar të realizohet për një periudhë 5-vjeçare në shumën 1,268,750 mijë lekë, nga të cilat janë programuar shuma 1,059,950 mijë lekë që është parashikuar të financohet nga buxheti i shtetit dhe shuma 208,800 mijë lekë si investim i huaj financiar nga Ambasada Suedeze.

Siç dihet tashmë është dakordësuar një marrëveshje nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Ambasadë Suedeze.



Për vitin 2025 ky projekt është parashikuar të realizohet në shumën prej 264,780 mijë lekë nga të cilat, shuma prej 212,000 mijë lekë është parashikuar nga buxheti i shtetit dhe shuma prej 52,780 mijë lekë nga investimi i huaj.

Po kështu janë programuar edhe për vitet 2026, 2027, 2028, 2029 për çdo vit buxhetor fondet si nga financimi i huaj ashtu edhe nga buxheti i shtetit.

Për projektin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve është propozuar pranë Ministrisë së Drejtësisë për t'u përfshirë edhe në "listën unike të projekteve me rëndësi kombëtare". Është dërguar i gjithë dokumentacioni i kërkuar si nga SPAK-u ashtu edhe nga Ministria e Drejtësisë.

Projekti Enterprise Service BUS (ESB), Implementimi i një ESB do të ndihmojë KLGJ-në me qëllim për të ofruar një qasje të unifikuar për komunikimin midis shërbimeve.

ESB-ja është një sistem kryesor që do të ndihmojë KLGJ-në të përmbushë këto objektiva dhe qëllime për të siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme, të sigurt dhe të përshtatshme për komunikimin dhe ofrimin e shërbimeve të tyre në konfigurime të tilla, të komplikuar ku sisteme të ndryshme komunikojnë midis tyre për të ofruar një informacion të plotë për përdorues brenda dhe jashtë KLGJ-së.

Më falni por janë të gjitha terma teknik të cilat janë marrë nga relacioni argumentues pjesor i përgatitur nga Departamenti i IT-së.

Ky projekt është parashikuar të realizohet për një periudhë 2-vjeçare në shumën 406,000 mijë lekë, të cilat për vitin 2025 janë parashikuar në shumën prej 203,000 mijë lekë dhe pjesa tjetër është parashikuar në vitin buxhetor 2026.

Tjetër projekt është edhe zgjidhja e qendëruar e raportimit dhe BI. Bazuar në detyrimet ligjore të ligjit 115/2016, i ndryshuar, prej kohësh sistemi gjyqësor kishte nevojë për një mënyrë të qendëruar raportimi dhe inteligjence biznesi (BI) për të siguruar raporte të përmbledhura dhe gjithëpërfshirëse rreth statistikave të përgjithshme të gjithë gjykatave së bashku por edhe të secilës në veçanti.

Ky instalim i qendëruar krijon mundësinë e përpunimit të informacionit dhe raporteve të unifikuara, si në përmbajtje ashtu edhe strukturë. Në të njëjtën kohë ofrohet mundësia e përpunimit të informacionit të shpejtë në çdo kohë, i cili mbledhet në mënyrë automatike nga të gjithë sistemet e tjera të KLGJ-së.

Ky projekt është parashikuar të realizohet në një periudhë 2-vjeçare, e shtrirë në dy vite buxhetore. Kështu për vitin 2025 është parashikuar në shumën prej 8,180 mijë lekë dhe për vitin 2026 në shumën tjetër 8,180 mijë lekë.

Projekti Integrimi i Inteligjencës Artificiale në proceset e punës. Implementimi i këtij projekti është një zgjidhje e cila përdor Inteligjencën Artificiale në ndihmë të KLGJ-së për të adresuar këto sfida duke ofruar një qasje të unifikuar për indeksimin, kërkimin dhe përpunimin e informacionit të kombinuar nga sistemet e ndryshme në administrim. Ky projekt është parashikuar të realizohet në periudhë dyvjeçare, e shtrirë në dy vite buxhetore, në shumën totale 487,200 mijë lekë, dhe për vitin 2025 është programuar shuma 243,600 mijë lekë dhe për vitin 2026 pjesa tjetër e shumës 243,600 mijë lekë.

Në këtë nënartikull kemi programuar dhe fonde për Gjykatën e Lartë në shumën 2,100 mijë lekë për blerjen e tre softuerëve: një për qendrën e dokumentacionit, një për krijimin e faqes web të KED-it, dhe një për krijimin e robotit AI për nxjerrjen e relacioneve të vendimeve të kësaj gjykate, kjo sipas kërkesës së bërë nga Gjykata e Lartë.

Po ashtu është programuar edhe për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, fonde në shumën 300 në mijë lekë pasi është e nevojshme të blihet program kompjuterik për kthimin e dokumenteve nga PDF në Word, Excel, si dhe licenca për 10 paketa Office për çdo vit buxhetor në periudhën 2025 – 2027.

Në kodin e projektit i cili nuk është përcaktuar akoma numri nga Ministria e Financës, duke qenë se është një kërkesë e re që konsiston në program softuerë për sigurinë kibernetike, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 90,000 mijë lekë me qëllim realizimin e projektit të “Rritja e kapaciteteve të sigurisë kibernetike”, e cila synon të zgjerojë strategjinë e zgjidhjes së mbrojtjes së të dhënave nga sulme të mundshme kibernetike, serverët virtualë apo fizikë që ka në infrastrukturën tonë ekzistuese.

Kështu, referuar shkresës së AKCESK dhe shkresës së ASKS (agjencitë për sigurinë kibernetike), mbi parashikimin në PBA të efekteve financiare “Për sigurinë kibernetike”, për Këshillin e Lartë Gjyqësor për vitin 2025 është vlerësuar në shumën 90,000 mijë lekë, për vitin 2026 në shumën 145,640 mijë lekë dhe për vitin 2027 në shumën 49,840 mijë lekë.

KLGJ-ja me shkresë zyrtare ka dërguar në Ministrinë e Drejtësisë propozimin për të gjitha projektet softuerë për t’u përfshirë në programin IPA III 2025-2027.

Kalojmë në Kodin e Projektit “Blerje pajisje elektronike”, e cila në total është programuar në shumën 124,200 mijë lekë të cilat sipas nënartikullit “Pajisje teknike” (server, rack cabinet, etj.) janë në shumën 5,750 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për plotësimin e nevojave në 8 gjykata.

Nënartikulli “Pajisje audio vizuale” (monitor, aparat TV, pajisje fonie, diktofon, sistem videokonference, ekran interaktiv) në shumën 14,750 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat e paraqitura për 10 gjykata.

Nënartikulli “Pajisje të tjera teknike” (scaner, router, switch, storage për server, hard disk, tablet, etj.) në shumën 19,300 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat për 9 gjykata.

Nënartikulli “Pajisje fotokopje” në shumën 4,600 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për plotësimin e nevojave për 6 gjykata.

Nënartikulli “Pajisje kompjuterike” (kompjuter, laptop) në shumën 64,600 mijë lekë dhe janë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për plotësimin e nevojave për 20 gjykata, në lidhje me kërkesat e tyre për 330 kompjuterë statik të rinj dhe 8 laptopë.

Nënartikulli “Pajisje të tjera zyre” (Printer, UPS Kompjuteri, UPS për server, etj.) në shumën 15,200 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për plotësimin e nevojave për 17 gjykata, për 72 printera, 296 UPS kompjuteri dhe 9 UPS serveri.

Kodi i projektit “Blerje pajisje zyre”, kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 296,720 mijë lekë dhe në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nënartikulli "Pajisje të tjera zyre (ku përfshihen grila, inverter, stabilizator tensioni, stendë afishim, flamur, stema, pompa, etj. pajisje zyre) janë në shumën 14,300 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat për 4 gjykata.

Nënartikulli "Pajisje që sigurojnë energji" në shumën 2,000 mijë lekë dhe është parashikuar kryesisht për të plotësuar nevojën e Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për blerjen e një motogjeneratori energjie.

Nënartikulli "Pajisje dhe instalim kondicioneri" në shumën 5,970 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat e paraqitura nga 7 gjykata.

Nënartikulli "Pajisje për mbrojtjen kundra zjarrit" në shumën 18,900 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat për 5 gjykata.

Nënartikulli "Pajisje për sistemin e sigurimit" akses kontroll, derë dedektimi, Skaner janë parashikuar në shumën 212,970 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat për 9 gjykata në shumën 39,870 mijë lekë, dhe për projektin e sigurisë për gjykatat, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 8.7.2020 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për garantimin e rregullit e të sigurisë në gjykata dhe prokurori" dhe kosto e parashikuar e këtij projekti për 10 gjykata është në shumën 446,400 mijë lekë dhe i shtrirë në dy vite buxhetore. Kështu për vitin 2025 është parashikuar shuma 173,100 mijë lekë ndërsa për vitin 2026 në shumën 273,300 mijë lekë. Edhe për projektin e sigurisë së gjykatave nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë propozimi për t'u bërë edhe kjo pjesë e programit IPA III 2025-2027.

Nënartikulli "Orendi zyre" kërkesat buxhetore janë në shumën 42,580 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për plotësimin e nevojave për 13 gjykata.

Në kodin e projektit "Blerje mjete motorike", kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 45,300 mijë lekë, nga të cilat në nënartikullin "Automjete, etj." në shumën 45,000 mijë lekë dhe janë parashikuar për blerjen e 15 copë automjeteve, për sistemin gjyqësor dhe për blerjen e një motoçiklete në shumën 300 mijë lekë, për blerjen e dy motoçikletave për plotësimin e nevojave të dy gjykatave siç e citova më sipër.

Ndërsa, për vitet buxhetore 2026 dhe 2027, në "Blerje mjete motorike" gjykatat nuk kanë paraqitur kërkesa, por nisur nga historiku i blerjeve të automjeteve, si dhe nga databaza që ka struktura përgjegjëse në KLGJ, kemi programuar fonde në shumën 30,000 mijë lekë për vitin 2026 dhe të njëjtën shumë për vitin buxhetor 2027.

Ndërsa, kërkesat buxhetore në "Shpenzime kapitale" (investime) (230+231), për vitin 2026 janë programuar në shumën 2,946,000 mijë lekë dhe për vitin 2027, janë programuar në shumën 2,644,000 mijë lekë.

Bashkëlidhur kërkesave buxhetore në "Shpenzime kapitale" (investime) (230+231), krahas relacioneve pjesore argumentuese që ju të nderuar anëtarë i kishit bashkëlidhur me relacionin e përcjellë, do të gjeni edhe Shtojcat nr. 1 "Formulari i prezantimit të Projekt-Idesë", Shtojca nr. 2 "Formulari i konceptimit të Investimit për Shpenzime Administrative Kapitale", Shtojca nr. 3 "Formulari i konceptimit të Projektit të Investimit", Shtojca nr. 4 "Studimi i vizibilitetit për çdo projekt të ri", të cilat janë

përgatitur nga ana jonë sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.887, datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar.

Këto ish-in kërkesat buxhetore për sistemin gjyqësor për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, faza e dytë, së bashku me tavanet përfundimtare të miratuara, sipas pasqyrave përmbledhëse, për të tre vitet buxhetore.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave buxhetore sipas dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, faza e dytë teknike, për sistemin gjyqësor, së bashku me pasqyrat përkatëse bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për durimin dhe vëmendjen, në pritje të ndonjë pritje të mundshme. Ju faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit zoti Haxhiu!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë pyetje ose paqartësi.

Nëse nuk kemi, kalojmë në votim?

***Albens Tabaku:*** Desha një pyetje.

***Naureda Llagami:*** Po Albens!

***Albens Tabaku:*** Në lidhje me nevojat që ka sistemi gjyqësor për godinat e reja dhe relacioni që bëri parafolësi në lidhje me nevojat që ka për rikonstruksione, godina të reja, ose Gjykata e Lartë që ka nevojë për një godinë të re, që kuptohet që është një nevojë emergjente, mirë po duke pasur parasysh që sipas nenit 13 të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” çdo 5 vjet bëhet edhe vlerësimi i organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave të gjykatave (të paktën çdo 5 vjet). Madje në nëntor më duket sikur KLGJ-ja duhet të japë edhe një shpjegim përpara Kuvendit Popullor në lidhje me mbarëvajtjen. Ne kemi edhe godinat e mëparshme të ish-gjykatave të apelit për shembull Korça, Shkodra, Vlora që janë në kushte shumë të mira, moderne. Jo më pak është edhe Durrësi. Disi më ndryshe ka

qenë Elbasani, jo aq modern në ndërtim, por sidoqoftë ka qenë edhe ajo një gjykatë. A nuk duhet marrë parasysh, sepse këto kërkesat për ndërtesat e reja të gjykatave, të rikonstruksioneve, kërkojnë fonde të mëdha, por ndërkohë sipas nenit 13, çdo 5 vjet duhet riparë harta gjyqësore, ndërkohë që edhe këto ndërtimet e reja kërkojnë një procedurë të gjatë tre vjet, katër vjet, pesë vjet, qoftë për marrjen e lejes së ndërtimit, qoftë për ndërtimin, kështu që a nuk duhet parë me një farë (si opinion po e them) kufizimi ose rezerve duke parë më tepër çështjet e emergjencave dhe prioriteteve, siç janë për shembull Gjykata e Lartë apo nevoja për plotësimin e vendeve vakante, të plotësimit të personelit për çështjen e backlog-ut, etj.

Kështu që unë nuk kam ndonjë vërejtje në aspektin teknik të ngushtë por në aspektin strategjik, pra kohëzgjatjes, ndoshta duhet të kemi parasysh që ne kemi edhe një rishikim të hartës por edhe disa gjykata të cilat janë inekzistente edhe në kushte shumë – shumë të mira, në qoftë se do të lihen kështu edhe do të amortizohen. Kjo është në përputhje edhe me auditimet e KLSH-së (me auditimin e përputhshmërisë së KLSH-së) domethënë që ne mund të ... edhe burimet e brendshme. Kështu që si opinion po them që duhet pasur një lloj prioriteti për ato që janë më emergjentet dhe të cilat të mos ketë një përplasje (një kresh “crash”) në të ardhmen, me një strategji që do të jetë ndoshta më e largët. Këto kisha unë.

*Naureda Llagami:* Atëherë Albens, në cilësinë e kryetares së Komisionit të Administrimit të Buxhetit por edhe të kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe duke qenë se kam qenë edhe pjesë e të gjithë reformave që ka marrë Këshilli i Lartë Gjyqësor që nga dita një, më lejo që të sqaroj që ajo që ju parashtroni në fakt ka të bëjë me ato godina të cilat nuk janë godina që kanë cenuar pjesën e hartës gjyqësore.

Lidhur me shqetësimin që ju parashtroni që ka të bëjë me godinat e apelit, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, së bashku me Prokurorinë e Përgjithshme, të gjithë këto godina janë vënë, janë akoma në administrim të gjykatave dhe të prokurorisë, dhe po gjinden dhe janë vënë në dispozicion për ato gjykata duke u lejuar që gjykatat të ndajnë dhomën civile me dhomën penale. Aty ku ne kërkojmë investime që me të drejtë zoti Haxhiu e përmendi, është Gjykata e Lartë e cila nuk ka një ambient të posaçëm për të qenë një gjykatë e lartë në kuadrin e... pra është

identifikuar që në vitin që kemi ardhur ne, jo më të konsideruar tashmë me situatën dhe rritjen e numrit të burimeve njerëzore që kemi pasur në atë gjykatë. Dhe Gjykata e Apelit e cila edhe ajo gjykatë, për shkak të hartës gjyqësore, i cili është një projekt i Këshillit dhe nuk është ende koha për rishikim, ne jo më larg se nëntori i vitit të kaluar konfirmuam hartën gjyqësore edhe Gjykata Kushtetuese dhe nuk mundemi dot ne të rishikojmë, ne po e monitorojmë hartën gjyqësore dhe këtë gjë do ta bëjmë për 5 vitet në vijim, derisa më pas të vlerësohet nga Këshilli që do të jetë në atë kohë, në rishikimin apo jo. Në aspektin e burimeve njerëzore ne e kemi evidentuar në mënyrë strategjike kush janë godinat dhe gjykatat në nevojë dhe kjo është për shkak të grupit të punës që kemi pasur mbi strategjinë e uljes së backlog-ut.

Grupi i punës ka mbaruar fazën e parë të tij ku ka dhënë rekomandimet mbi gjykatat në nevojë dhe përkrah këtij grupi pune ka qenë edhe një grup tjetër i punës që ka të bëjë me infrastrukturën. Kemi evidentuar nevojën që kemi për infrastruktura në ato gjykata. Pra të gjithë gjykatat e apelit janë gjykata që tashmë administrojnë arkivat që kanë gjykatat e shkallës së parë apo gjykatat që mbliidhen aty dhe gjithashtu në ato gjykata janë zyrat e komunikimit me publikun që janë pjesë e këtyre gjykatave; dhe ajo që po shihet tashmë dhe nga ana e Këshillit janë marrë masa për përditësimin e këtyre gjykatave dhe për meremetimin e tyre për t'i bërë këto gjykata funksionale në eventualitetin kur të gjithë strukturat do të jenë të plotësuara, sikurse kemi filluar punën me Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastër, e cila po ndahet në dy seksione ku do jetë seksioni civil dhe ai penal. E njëjta gjë është bërë me Gjykatën e Durrësit, me Gjykatën e Vlorës e njëjta gjë po shkohet, por këto janë procese të cilat, dhe ju do i kuptoni edhe më mirë, janë procese që zgjasin sepse përditësimi dhe mënyra se si vihen në lëvizje kërkojnë fonde, kërkojnë mbështetje financiare. Kur flasim për buxhet, më pas buxheti nuk është diçka që neve e kemi aty kur e duam vetë. Pra ne duhet të planifikojmë siç kemi planifikuar vjet për ato që kemi realizuar këtë vit dhe duhet të planifikojmë këtë vit për vitin e ardhshëm, ku ashtu sikurse e shpjegoi zoti Haxhiu, ne këtë vit do rregullojmë situatën në mënyrë të përkohshme për Gjykatën e Apelit Tiranë dhe për shkak të negociatave që kemi pasur me Ministrinë e Drejtësisë, ajo që parashikohet është që do merret një ambient me qira, ku lejon mundësinë që trupa gjyqësore së bashku me stafin e

gjykatës së ketë kushtet normale për zhvillimin e gjykimeve duke krijuar edhe mundësi aksesit të gjithë palëve. Pra këto janë të gjithë veprime strategjike.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, të publikuar në faqen e tij zyrtare ka të gjithë aktet e tij strategjike ku dëshmon, dhe kjo është dhe fryma që ka pasur Këshilli, dëshmonë mënyrën e veprimtarisë së tij që ka bërë hap pas hapi. Dhe buxheti, ashtu sikurse e përmendi edhe drejtori nuk është gjë tjetër vetëm zbatimi i këtyre veprimeve strategjike të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kështu që, për të gjithë këto informacione ne mund t'ju vëmë në dispozicion të gjithë aktet e karakterit strategjik, të gjithë vendimmarrjet që kemi pasur me organet e tjera të sistemit të drejtësisë, ku përfshihet Prokuroria e Përgjithshme i cili është administratori i të gjithë zyrave të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë dhe Ministria e Drejtësisë e cila është përgjegjëse për pjesën e administrimit dhe truallit shtetëror. Kështu që ne kemi një grup pune që ka bërë një analizë dhe ka bërë një ndarje të këtyre dhe një funksionim më të mirë të godinave ekzistuese.

Ajo që ne synojmë është si të përmirësojmë këto godina ekzistuese dhe kemi katër vjet që synojmë të kemi një truall për Gjykatën e Lartë apo për Gjykatën e Fierit, apo për Gjykatën e Tiranës dhe deri tani, nga ana e pushtetit lokal po ashtu edhe nga ana e pushtetit qendror, nuk kemi marrë ndonjë përgjigje le të themi pozitive apo konkrete, se përgjigje pozitive mund të kemi, por jo diçka konkrete. Dhe ne prapë i parashtrojmë këto edhe përpara Kuvendit duke “ngritur zërin” (në thonjëza) mbi nevojat që ka gjyqësori. Por për pjesën strategjike më lejoni t'ju referoj, të gjithë aktet strategjike i kemi në uebsajtin tonë ku ne veprojmë vetëm në mënyrë strategjike sepse nuk kemi si të veprojmë ndryshe në një sistem dhe një pushtet siç është gjyqësori.

Ndonjë diskutim tjetër?

Jo!

Nëse jo, kalojmë në votim. Irena!

**Irena Plaku:** Pro.

**Naureda Llagami:** Genta!

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Ridvan!

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Bledi!



*Bledar Bajri*: Dakord me miratimin.

*Naureda Llagami*: Albens!

*Albens Tabaku*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Yllka!

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Naureda Llagami*: Markeliani!

*Markelian Koça*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Mona!

*Emona Muçi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Klodi!

Ok, Klodi dhe Iliri në fakt më kanë njoftuar që sot e kanë të pamundur, duke qenë se janë në periudhë pushimesh.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, faza e dytë, për sistemin gjyqësor (Këshillin e Lartë Gjyqësor, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë dhe Gjykatat), sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 28.08.2024)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës viti akademik 2024-2025”, relatore znj Emona Muçi.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:09 dhe mbaroi në orën 13:42.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Irena Plaku\**** (anëtare)
3. ***Gentiana Muçaj\**** (anëtare)
4. ***Ridvan Hado\**** (anëtar)
5. ***Bledar Bajri*** (anëtar)
6. ***Albens Tabaku\**** (anëtar)
7. ***Markelian Koça\**** (anëtar)
8. ***Yllka Rupa\**** (anëtare)
9. ***Emona Muçi*** (anëtare)

***Shënim:*** Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. ***Ilir Rusi***

34

---

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 28.08.2024 (Pika 2)***

dhe z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Valbona Bala, eksperte pranë EWWMI/INL.*
7. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magistraturës viti akademik 2024-2025”, relatore znj Emona Muçi.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek akti tjetër i cili nuk është më pak i rëndësishëm. Shkurtimisht zonja Muçi do na prezantojë projekt-aktin mbi caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale për magistratët, 2024-2025.

*Emona Muçi:* Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve.

Uroj të keni kaluar pushime të mbara dhe të gëzuara.

Në lidhje me relacionin shkurtimisht në mënyrë të përmbledhur relatoj se Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016, përcakton gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Me vendimin nr. 301, datë 18.06.2024 Këshilli ka

miratuar trupën e gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024-tetor 2027, ndryshuar me vendimin nr. 334, datë 09.07.2024.

Në datën 31.07.2024, nëpërmjet postës elektronike Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë listën e kandidatëve për gjyqtarë, të cilët do të kryejnë praktikën profesionale gjatë periudhës 2024-2025 pranë gjykatave të shkallës së parë.

Në referim të nenit 33 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, si dhe ligjit nr.115/2016, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton gjykatat e shkallës së parë në lidhje me kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët për magistratë, si dhe trupën e magistratëve udhëheqës, të cilët do të kryejnë vlerësimin etik dhe profesional për secilin kandidat.

Në lidhje me përcaktimin e gjykatave pranë të cilave do të kryhet praktika profesionale, ligji përcakton kriteret ashtu edhe në lidhje me trupën gjyqësore, domethënë duke iu referuar nenit 33, pika 2 të ligjit 96/2016.

Referuar kriterëve ligjore si më sipër, është vlerësuar që të jenë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Vlorë, gjykatat që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magistratë, profili gjyqtar, gjatë vitit akademik 2024-2025. Një përcaktim i tillë bëhet duke konsideruar:

(i) Ecurinë e praktikës profesionale të kandidatëve për gjyqtarë të zhvilluar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në vitet 2017-2023;

(ii) Numrin e kandidatëve për gjyqtarë që do të zhvillojnë praktikën profesionale në vitin akademik 2024-2025. Referuar kërkesës dhe praktikës së përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se në këtë periudhë kohore do të ndjekin praktikën profesionale 46 (dyzet e gjatë) kandidatë për gjyqtarë;

(iii) Numrin e gjyqtarëve që kanë shprehur gatishmërinë për t'u përfshirë në listën e magistratëve udhëheqës për secilën nga gjykatat si më sipër;

(iv) Përfshirjen e gjyqtarëve që kanë ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe gjyqtarët me përvojë profesionale të gjatë;

(v) Madhësinë dhe infrastrukturën e gjykatave respektive me qëllim krijimin e

kushteve sa më optimale për veprimtarinë gjatë praktikës profesionale për kandidatët për gjyqtarë;

(vi) Klasifikimin e gjykatave respektive si gjykata të cilat kanë në kompetencën lëndore dhe tokësore të tyre një gamë të gjerë mosmarrëveshjes në fushat kryesore të së drejtës civile, penale dhe administrative;

(vii) Kërkesat e paraqitura nga kandidatët për gjyqtarë për të zhvilluar praktikën profesionale në gjykata të ndryshme, referuar rrethanave që ata kanë bërë prezent, vlerësuar në raport me mundësitë objektive për të zhvilluar praktikën në gjykatat respektive dhe numrin e gjyqtarëve të këtyre gjykatave, që kanë shprehur vullnetin për t'u bërë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës.

Konkretisht, pranë Këshillit, janë paraqitur disa kërkesa:

Kandidatja për gjyqtare {...}, në datë 03.04.2024, ka paraqitur një kërkesë ku ka shprehur vullnetin për të kryer praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin që lidhet me arsyet familjare;

Po kështu kandidatja për gjyqtare {...}, në datën 04.04.2024, po kështu ka shprehur vullnetin për të kryer praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (për çështjet penale), pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (për çështjet civile), dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin ku justifikohet për arsyet familjare të saj;

Kandidati për gjyqtar {...}, në datë 03.05.2024, ka paraqitur po ashtu një kërkesë duke shprehur vullnetin për të kryer praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për arsye familjare.

Lidhur me këto kërkesa, Komisioni vlerëson se ato mund të konsiderohen pjesërisht në përcaktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës pranë të cilëve kandidatët do të kryejnë praktikën profesionale duke vlerësuar:

- (i) Vullnetin e shprehur nga kandidatët;
- (ii) Numrin e gjyqtarëve të cilët janë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës me vendimin nr. 301, i ndryshuar me vendimin nr.334, të Këshillit;

(iii) Madhësinë dhe infrastrukturën e gjykatave të kërkuara nga kandidatët, me qëllim krijimin e kushteve sa më optimale për zhvillimin e praktikës profesionale dhe krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë kandidatët për të kryer praktikën profesionale në mënyrë sa më cilësore, në drejtim të natyrës dhe sasisë së çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat përkatëse, referuar juridiksionit dhe madhësisë së tyre.

Duke vlerësuar kushtet e mësipërme, Komisioni vlerëson se kërkesa e kandidatës {...} për të kryer praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (për çështje penale) dhe pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (për çështje civile), duhet të pranohet, pasi të dyja gjykatat e mësipërme plotësojnë kriterin ligjor lidhur me madhësinë dhe infrastrukturën, me qëllim krijimin e kushteve sa më optimale për zhvillimin e praktikës profesionale dhe krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë kandidatët për të kryer praktikën profesionale në mënyrë sa më cilësore. Ndërsa lidhur me numrin e mjaftueshëm të gjyqtarëve udhëheqës, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë vetëm dy gjyqtarë në listën e miratuar nga Këshilli që janë pjesë e seksionit penal, ndërsa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nuk ka ende ndarje të seksioneve midis gjyqtarëve, por ka dy gjyqtarë udhëheqës në listën e miratuar.

Lidhur me kërkesën e kandidatës {...}, komisioni vlerëson se duhet të pranohet vetëm për pjesën e kryerjes së praktikës profesionale për çështjet penale, pasi gjyqtarët udhëheqës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të miratuar nga Këshilli janë pjesë e seksionit penal. Po kështu, edhe lidhur me kërkesën e kandidatit {...}, Komisioni vlerëson se duhet të pranohet vetëm për pjesën e kryerjes së praktikës profesionale për çështjet penale, pasi dy gjyqtarët udhëheqës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të miratuar nga Këshilli janë pjesë e seksionit penal.

Sa i përket caktimit të kandidatëve pranë gjyqtarëve udhëheqës për të kryer praktikën profesionale, rezulton se për gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pranë të njëjtit gjyqtar janë caktuar dy ose tre kandidatë për gjyqtarë. Caktimi i më shumë se një kandidati pranë të njëjtit gjyqtar është i kushtëzuar nga shkaqet e mëposhtme:

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në të cilën do të kryejnë praktikën profesionale të gjithë kandidatët për gjyqtarë, të ndarë në tre periudha 4-mujore, ushtrojnë aktualisht detyrën 6 (gjashtë) gjyqtarë të cilët janë të përfshirë në trupën e gjyqtarëve udhëheqës, ndërkohë që numri i kandidatëve është 46 (dyzet e gjashtë) dhe të ndarë sipas periudhave rezulton së për secilën periudhë duhet të atashohen pranë 6 (gjashtë) gjyqtarëve përkatësisht 15, 15 dhe 16 kandidatë.

Për këto arsye, në periudha përkatëse 4-mujore, pranë gjashtë gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë do të atashohen për të kryer praktikën profesionale nga dy ose tre kandidatë. Përcaktimi i gjyqtarëve pranë të cilëve do të atashohen më shumë se një kandidat për magistrat është bërë duke konsideruar (i) përvojën e tyre si gjyqtarë udhëheqës, (ii) pjesëmarrjen në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magistraturës lidhur me mentorimin dhe (iii) eksperiencën e tyre profesionale.

Për këto arsye, në pikën 1 të projektvendimit, është parashikuar caktimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan dhe Vlorë si gjykatat që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magistratë, profili gjyqtar, gjatë vitit akademik 2024-2025.

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar caktimi i gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2024-2025, sipas listës bashkëngjitur këtij projektvendimi, duke konsideruar gatishmërinë e shprehur prej tyre pas thirrjes që i është drejtuar nga Këshilli, plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ndjekjen e programit trajnues, si dhe përvojën e tyre profesionale.

Në pikën 3 të këtij projektvendimi është përcaktuar se magistrati udhëheqës bën vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat për gjyqtar, sipas kritereve dhe treguesve të përcaktuar në Ligjin për Statusin, referuar formatit standard të miratuar më parë nga Këshilli me vendimin nr. 37, datë 28.02.2019.

Në pikën 4 të këtij projektvendimi parashikohet se magistrati udhëheqës përjashtohet nga hedhja e 10-të e shortit për ndarjen e çështjeve në gjykatën pranë të cilës ushtron funksionin, të organizuar gjatë periudhës që kandidatët për gjyqtarë ushtrojnë praktikën profesionale.

Në pikën 5 të projektvendimit parashikohet shtesa mbi pagën mujore të magjistratit udhëheqës në masën 5% shtesë mbi pagën bruto fillestare të tij, në referim të parashikimeve të nenit 14, pika 2 të Ligjit për Statusin.

Në pikën 6 të projektvendimit parashikohet e drejta e kandidatëve për magjistratë për pushime vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat 15 ditë merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin udhëheqës, sikurse përcaktohet në nenin 33, pika 7 të Ligjit për Statusin.

Në pikën 7 të projektvendimit parashikohet njoftimi i tij Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përfshirjen e gjyqtarëve udhëheqës në programin e trajtimit, si dhe njoftimi i gjyqtarëve udhëheqës dhe gjykatave në të cilat ata ushtrojnë funksionin.

Së fundmi, parashikohet momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi i cili hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, nëse nuk kemi diskutime...?

Po!

Nuk kemi!

Atëherë në qoftë se s'kemi diskutime, do propozoja të kalonim në procedurën e votimit të projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni. Irena!

**Irena Plaku:** Pro.

**Naureda Llagami:** Genta!

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Ridvan!

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Bledi!

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Albens!

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Markelian!

**Markelian Koça:** Dakord.



*Naureda Llagami:* Yllka!

*Yllka Rupa:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

*Emona Muçi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Po, Emona dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, projekt-akti miratohet sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Kështu me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit për mirëkuptimin, duke qenë se muajin gusht ne e kemi muaj pushimesh.

Ju uroj pushime të mbara për ato që janë me pushime dhe fillim pune të mbarë për ato që do e fillojnë.

Faleminderit!

Mirupafshim!

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**